VENDIM
Nr. 764, datë 20.12.2017

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT PARAUNIVERSITAR TË ARSIMIT BAZË "SCUOLA ITALIANA A TIRANA"

(ndryshuar me VKM nr.372, datë 22.6.2021)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar të arsimit bazë "Scuola Italiana a Tirana".

2. Institucioni arsimor privat parauniversitar i arsimit bazë "Scuola Italiana a Tirana" ushtron veprimtarinë arsimore në adresën: rruga "Rauf Fico", ndërtesa 11, njësia nr.5, 1022, Tiranë.

3. Në institucionin arsimor privat parauniversitar të arsimit bazë "Scuola Italiana a Tirana" mësimi do të zhvillohet edhe në gjuhë të huaj (në gjuhën italiane). Lëndët "Gjuha shqipe", "Historia e kombit shqiptar" dhe "Gjeografia e Shqipërisë" zhvillohen detyrimisht në gjuhën shqipe.

4. Forma e mësimdhënies në institucionin arsimor privat parauniversitar të arsimit bazë "Scuola Italiana a Tirana" të jetë me kohë të plotë.

5. Institucioni arsimor privat parauniversitar i arsimit bazë "Scuola Italiana a Tirana", me fillimin dhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij të raportojë në njësinë arsimore vendore, brenda afateve të përcaktuara për:

a) numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve të arsimit bazë, të regjistruar në fillim dhe që do të mbarojnë vitin shkollor, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe statistikave të miratuara nga INSTAT-i;

b) planin mësimor, programet lëndore dhe strukturën që do të ketë institucioni në fillim të çdo viti shkollor;

c) aktin e regjistrimit në organin tatimor;

ç) listën e veprimtarive jashtëshkollore që janë parashikuar të zhvillohen gjatë vitit shkollor;

d) adresën e institucionit, adresën elektronike (*e-mail*) dhe numrin e telefonit.

6. Institucioni arsimor privat parauniversitar i arsimit bazë "Scuola Italiana a Tirana" duhet të miratojë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë çdo ndryshim në planin mësimor, programet e lëndëve apo tekstet që do të përdorë, si edhe çdo projekt apo eksperimentim psiko-pedagogjiko-didaktik që kërkon të kryejë, sipas rastit.

7. Ndryshimet, që mund të pësojë institucioni arsimor privat parauniversitar i licencuar në vendndodhjen dhe në infrastrukturën e godinës, shqyrtohen dhe miratohen në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pas miratimit të njësisë arsimore vendore, 3 (tre) muaj para fillimit të vitit shkollor përkatës.

8. Institucioni arsimor privat parauniversitar i arsimit bazë "Scuola Italiana a Tirana" duhet të ketë në ruajtje dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentacionin themeltar në ruajtje të përhershme, si: regjistër amze, indeks alfabetik, regjistër të veçantë, statistika vjetore të numrit të nxënësve dhe të mësuesve;

b) Regjistra të përkohshëm, si: regjistra klase, evidencë për lëvizjen e nxënësve (i detyrueshëm për

institucionin arsimor privat parauniversitar);

c) Rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit;

ç) Kriteret për pranimin e nxënësve e të mësuesve;

d) Kontratat me prindërit për shërbimet arsimore apo shërbime të tjera jashtëshkollore që ofron;

dh) Kontratën e punës me mësuesit (për ata me kohë të plotë apo të pjesshme).

9. Dokumentacioni, sipas kërkesave të përcaktuara në pikat 6 dhe 8, u vihet në dispozicion organeve kompetente mbikëqyrëse.

10. Moszbatimi apo mosrespektimi i këtyre detyrimeve, si dhe mosdhënia apo fshehja e informacioneve nga organet kompetente mbikëqyrëse e inspektuese përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

11. Mosfillimi i veprimtarisë së institucionit arsimor privat brenda periudhës dyvjeçare nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e bën këtë leje të pavlefshme.

11/1. Subjekti, para hapjes së çdo klase të arsimit të mesëm të ulët dhe fillimit të veprimtarisë për këtë nivel arsimor, deklaron në ministrinë përgjegjëse për arsimin, 3 (tre) muaj para fillimit të vitit shkollor përkatës, personelin mësimdhënës për këto klasa dhe çdo ndryshim tjetër, duke përcjellë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas përcaktimeve të vendimit nr.466, datë 10.6.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për hapjen dhe mbylljen e institucioneve private të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj".

Institucioni mund të fillojë veprimtarinë për klasat e arsimit të mesëm të ulët, për vitin shkollor, vetëm pas miratimit të ministrisë përgjegjëse për arsimin për personelin mësimdhënës dhe çdo ndryshimi tjetër.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria Arsimore Rajonale e Qytetit të Tiranës dhe institucioni arsimor privat parauniversitar i arsimit bazë "Scuola Italiana a Tirana" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi